




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.66/2024

Datë: 7 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 105 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 67 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në takimin 322-të, të mbajtur me datë 7 mars 2024 merr këtë:

## V E N D I M

- I. Z. Haki Gashi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë – Dega Klinë, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqarit, për shkak të përfundimit të mandatit, me arritjen e moshës së pensionimit me datë 6 prill 2024.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 mars 2024.

## A r s y e t i m

Konform nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, gjyqtarit Haki Gashi, sipas fuqisë ligjore i përfundon mandati i gjyqarit, pasi që i njëjti me datë 6 prill 2024, arrin moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

KGJK, bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i propozon Presidentes së Republikës së Kosovës Sh.S.Znj. Vjosa Osmani – Sadriu, të liroj nga detyra gjyqtarin Haki Gashi.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit.